

Këshilla të përshtatshme për parandalimin e zjarreve në shtëpi



Tre nga katër rastet e zjarreve ndodhin në shtëpi dhe zakonisht vijnë si rezultat i neglizhencës ose defekteve. Mbani mend që është më e lehtë ta parandaloni zjarrin, sesa ta fikni.

Defektet elektrike

Në shtëpitë tona kemi shumë lloje të ndryshme pajisjesh elektroshtëpiake dhe nëse nxehen shumë, ose nuk përdoren siç duhet, këto mund të shkaktojnë rënien e zjarreve. Nëse nuhatni ndonjë erë të dyshimtë, ose dëgjoni zhurma në sistemin elektrik, atëherë kontaktoni një elektromontator. Është gjithmonë më mirë që një punonjës profesional të merret me riparimin e kabllave dhe të pajisjeve elektroshtëpiake. Zjarret elektrike mund të parandalohen gjithashtu duke ndjekur disa masa shumë të zakonshme. Fikeni gjithmonë televizorin tek priza, mos lini ndezur tharëset me centrifugë, makinat rrobalarëse dhe makinat pjatolarëse, kur dilni nga shtëpia ose kur shkoni të flini. Mos i thani asnjëherë rrobat tek radiatorët ose tek ngrohësit me avuj. Mësohuni që t'i hiqni nga priza bukëthekësit dhe hekurat (për hekurosje). Instaloni një celës qarku.

Qirinjtë dhe zjarret e hapura

Të harruarit e fikjes së qirinjve është shkak i rënies së shumë zjarreve në shtëpitë tona. Mos i vendosni qirinjtë pranë perdeve ose televizorit. Përdorni shandanë që janë të bërë me materiale që nuk marrin zjarr, si p.sh., qeramikë, xham ose kallaj. Mos përdorni shandanë druri. Mësohuni që të mos dilni asnjëherë nga dhoma, pa fikur më parë qirinjtë.

Fëmijët kanë treguar gjithmonë interes ndaj zjarrit, kështu që është e rëndësishme që ata të mësojnë si ta trajtojnë. Mos e frikësoni asnjëherë një fëmijë për zjarrin – kjo thjesht do të rrisë kuriozitetin e fëmijës. Mos e lini asnjëherë një fëmijë vetëm në shtëpi me qiri të ndezur ose zjarr të ndezur të hapur.

Duhani

Duhani është një nga shkaqet më të përhapura të zjarrit me rezultate vdekjeprurëse. Nuk është vetëm pirja e

duhanit në krevat që e bën të rrezikshme pirjen e duhanit; po aq e rrezikshme është të të zërë gjumi duke pirë duhan në kolltuk ose divan. Lageni tavllën nga brenda, para se ta zbrazni.

Kuzhina mund të jetë rrezik zjarri

Shumë zjarre fillojnë nga soba. Gatimi i thatë është një shkak i zakonshëm i rënies së zjarrit. Yndyrnat dhe vaji digjen kur rritet temperatura, njëkohësisht dhe stearina. Mos lini asnjëherë asgjë në sobë duke u zier, pa qenë të pranishëm. Mbikqyrja e sobave automatike është një metodë e mirë për t'iu shmangur zjarreve që bien në sobën e gatimit – mund të lexoni më tepër për të në faqen e internetit www.brandsakerthem.se.

Mbajtja sa më pastër që të jetë e mundur e ventilatorit të kuzhinës, mund të ndihmojë rrezikun e zjarrit në kuzhinë, meqenëse yndyrnat dhe bloza digjen mjaft lehtë.

Lëndët djegëse

Benzina, substancat e metiluar, parafina dhe lëngjet për ndezjen e zjarrit, që të gjitha marrin zjarr shpejt. Mbajini këto lëngje në enë të përshtatshme dhe në vende ku nuk i gjejnë fëmijët.

Ndizeni skarën e pjekjes duke përdorur lëngje për ndezjen e zjarrit. Mos përdorni asnjëherë benzinë ose substanca të metiluar.

Mos hidhni asnjëherë spërkatësa aerosoli në zjarre të hapura, sepse kjo mund të shkaktojë një shpërthim të madh.

Gazi me bombul është lëndë që ndizet shumë shpejt, kështu që është e rëndësishme që të trajtohet ashtu siç duhet. Fikeni valvulën kur të keni mbaruar së përdoruri gazin me bombul. Nëse përdorni gaz me bombul në një varkë ose karvan, atëherë është e rëndësishme që të kontrolloni rregullisht lidhjet, valvulat dhe tubat, për t'u siguruar që nuk janë dëmtuar. Lexoni më tepër në fletëpalosjen me këshilla të përshtatshme nga Shoqata Suedeze për Mbrojtjen nga Zjarri, për sa i përket përdorimit të gazit me bombul në karvanë.

Zjarrvënia

Lagjet rezidenciale shpeshherë janë në shënjestër të sulmeve të vënies së zjarrit. Mënyra më e mirë për ta parandaluar këtë është që të mos mbani shumë materiale që ndizen shpejt poshtë shkallëve, apo në vende të tjera që gjenden lehtë. Është gjithashtu e rëndësishme që të mbani mbyllur papafingon, bodrumin dhe garazhet dhe të siguroheni që dritat punojnë. Këto masa i vështirësojnë gjërat

akoma më shumë për personat që vënë zjarr me qëllim.

Për t'ju ardhur në ndihmë

Alarmet e zjarrit

Në raste zjarri, tymi është më i rrezikshmi dhe që shkakton vdekje. Alarmi i zjarrit reagon ndaj tymit të rrezikshëm dhe ju zgjon nga gjumi. Kontrollojini rregullisht alarmet tuaja të zjarrit. Lexoni më tepër në fletëpalosjen me këshilla të përshtatshme nga Shoqata Suedeze për Mbrojtjen nga Zjarri për alarmet e zjarrit në shtëpi.

Fikësi i zjarrit që mbahet në dorë

Një fikës zjarri që mbahet në dorë është një vegël e shkëlqyer për fillimin e shuarjes së zjarrit. Çdo person në familje duhet të dijë se si funksionon fikësi i zjarrit dhe se ku vendoset. Mund të lexoni më tepër në fletëpalosjen me këshilla të përshtatshme nga Shoqata Suedeze për Mbrojtjen nga Zjarri për Zgjedhjen e fikësit të përshtatshëm.

Plani i evakuimit

Bëni një plan evakuimi së bashku me fëmijët tuaj. Nëse është e mundur, sigurohuni që të keni të paktën dy dalje të ndryshme në rast urgjence për çdo person në familje. Sigurohuni që të mund të dilni, nëse ka rënë zjarr në apartamentin tuaj. Mos e mbyllni derën nga brenda me dry me kllapa. Vendoseni planin e evakuimit në një vend që e shohin të gjithë dhe vendosni për një vend takimi jashtë ndërtesës. Bëjeni të lehtë evakuimin nga shtëpia duke instaluar, për shembull, një shkallë evakuimi.

A është e sigurtë shtëpia juaj?

- Hiqini të gjitha materialet që marrin flakë shpejt që janë afër sobës.
- Hiqeni nga priza pajisjen e kafesë dhe bukëthekësin kur nuk përdoren. Instaloni një kronometër.
- Sigurohuni që llambat të kenë vat të përshtatshëm dhe që kordonat zgjatues nuk janë shtypur.
- Zëvendësojini prizat/signuresat e rrymës dhe shtrëngoni ato që janë liruar.
- Mos thani peshqirë në radiatorë, ose objekte të tjera të bëra me materiale që marrin flakë shpejt.
- Fikini qirinjtë kur të dilni nga dhoma.
- Nëse digjen signuresat, atëherë kërkojini elektrikistit të gjejë defektin.
- Hiqini nga prizat kabllot elektrike dhe ajrore në raste kur ka stuhi me bubullima.
- Sigurohuni që ka ajër të mjaftueshëm rreth e përfaqar televizorit tuaj.
- Hiqini copat, qirinjtë dhe ndonjë gjë tjetër mbi televizor që mund të shkaktojnë zjarr.
- Sigurohuni që ventilatori në kuzhinë të jetë i pastër.
- A keni alarme zjarri dhe ku ndodhen?
- A keni në shtëpi një bombol për shuarjen e zjarrit?
- Pastroni me fshesë elektrike mbrapa frigoriferit dhe/ose ngrirësit.
- Sigurohuni që qirinjtë të mos jenë vendosur pranë perdeve, apo diçka të ngjashme, dhe të kenë dekorime që nuk marrin flakë shpejt.
- Instaloni një çelës qarku.

TELEFONONI GJITHMONË 112 NË RASTE ZJARRI

Shoqata Suedeze për Mbrojtjen nga Zjarri është një organizatë anëtare, e cila punon për ta bërë Suedinë një vend më të sigurtë. Me anë të informatave dhe trajnimeve, ne i ndihmojmë njerëzit, kompanitë dhe organizatat që të jenë përgjegjëse për parandalimin e zjarrit. 08-588 474 00. www.brandskyddsforeningen.se